3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit 1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës 1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare;
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

- 25. Procedura e ankesës**
1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
 2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

- 26. Anulimi i procedurës**
1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
 2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

- Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike
- Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës
- Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial
- Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit
- Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike
- Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit
- Shtojca 8: Termat e Referencës
- Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve
- Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....
- Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....
- Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit
- Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit
- Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit
- Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit
- Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë
(në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	Çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1	Shërbim fotografimi	5			
2	Shërbim videografimi/filmimi	5			
3	Realizim montazh/përpunim video/foto	25			
4	Shërbim filmimi me dron	5			
5	Shërbim skenë me qira	2			
6	Shërbim foni me qira	2			
7	Shërbim LED me qera	1			
8	Shërbim DJ	2			
9	Shërbim grup me animatore dhe maskota	12			
10	Fishekzjarre	1			

11	Shërbim ndriçimi dhe projektimi	1			
12	Kor fëmijësh	2			
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik "....." për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik "....." të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiruar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6 .

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Nr.	Përshkrimi i shërbimit	Njësia	Sasia e pritshme	Afatet e ekzekutimit
1	Shërbim fotografimi	evente	5	12 muaj nga nënshkrimi i MK
2	Shërbim videografimi/filmimi	evente	5	12 muaj nga nënshkrimi i MK
3	Realizim montazh/përpunim video/foto	video	25	12 muaj nga nënshkrimi i MK
4	Shërbim filmimi me dron	evente	5	12 muaj nga nënshkrimi i MK
5	Shërbim skenë me qira	evente	2	12 muaj nga nënshkrimi i MK
6	Shërbim foni me qira	evente	2	12 muaj nga nënshkrimi i MK
7	Shërbim LED me qera	evente	1	12 muaj nga nënshkrimi i MK
8	Shërbim DJ	evente	2	12 muaj nga nënshkrimi i MK
9	Shërbim grup me animatore dhe maskota	evente	12	12 muaj nga nënshkrimi i MK
10	Fishekzjarre	evente	1	12 muaj nga nënshkrimi i MK
11	Shërbim ndriçimi dhe projektimi	evente	1	Afati i lëvrimit
12	Kor fëmijësh	evente	2	12 muaj nga nënshkrimi i MK

Afati i MK: 12 (dymbëdhjetë) muaj nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër.

Afatet e ekzekutimit të minikontratave: 10 (dhjetë) ditë nga nënshkrimi i kontratave, dhe brenda afatit 12 (dymbëdhjetë) mujor të Marrëveshjes Kuadër.

Vendi i realizimit të shërbimeve: Kopshti Zoologjik i Tiranës, me adresë Rruga "Liqeni i Thatë", Tiranë, Shqipëri

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Nisur nga fakti se Kopshti Zoologjik është një ndër atraksionet më të mëdha të qytetit të Tiranës, duke përfshirë vizitorët vendas dhe të huaj, një ndër planifikimet kryesore ku jemi fokusuar janë aktivitetet për ditë të caktuara festive. Këtu vlen të përmenden festat në prag të fundvitit, apo ditë të tjera të shënuara, në të cilat Kopshti Zoologjik priret të presë një numër më të lartë vizitorësh.

Në mënyrë që të mund të organizojmë një ambient festiv, mikëpritës dhe tërheqës jo vetëm për fëmijët por për të gjitha grupmoshat, është konsideruar si domosdoshmëri organizimi i buxhetit për realizimin e procedurave mbi evente të ndryshme në Kopshtin Zoologjik, në ditët festive.

Për shkak se eventet në Kopshtin Zoologjik do të realizohen për herë të parë si procedurë (duke mos përcaktuar dot me saktësi të gjithë sasitë e nevojshme të shërbimeve që kërkohen) të cilat duhet të përshtaten me aktivitetet që do të realizohen, është e domosdoshme dhe e nevojshme lista e pritshme e shërbimeve si më poshtë:

Nr	Përshkrimi i shërbimit	Njësia	Sasia e pritshme
1	Shërbim fotografimi	evente	5
2	Shërbim videografimi/filmimi	evente	5
3	Realizim montazh/përpunim video/foto	video	25
4	Shërbim filmimi me dron	evente	5
5	Shërbim skenë me qira	evente	2
6	Shërbim foni me qira	evente	2
7	Shërbim LED me qera	evente	1
8	Shërbim DJ	evente	2
9	Shërbim grup me animatore dhe maskota	evente	12
10	Fishekzjarre	evente	1
11	Shërbim ndriçimi dhe projektimi	evente	1
12	Kor fëmijësh	evente	2

1. Shërbim fotografimi

- Planifikimi dhe Përgatitja:** Diskutim me Autoritetin Kontraktor për të kuptuar qëllimin e eventit, pritshmëritë për fotografitë, momentet kryesore dhe pjesëmarrësit. Sigurimi që të gjitha pajisjet fotografike, duke përfshirë kamerat, lentet, bateritë, kartat e memories, ndriçimin dhe aksesoret, të jenë të gatshëm dhe të kontrolluar përpara eventit. Humultimi i vendit të eventit për të kuptuar kushtet e ndriçimit, hapësirat më të mira për të shkrepur fotografitë dhe çdo sfidë të mundshme teknike që mund të shfaqet.

-
- **Fotografimi i momenteve të rëndësishme:** Sigurimi që momentet kryesore të eventit të jenë të kapura, si hyrja e të ftuarve, përshëndetjet e organizatorëve, fjalimet, performancat dhe çdo ngjarje tjetër që është pjesë e programit.
 - **Fotografimi i detajeve gjatë eventit:** Përqendrim në detajet që përfaqësojnë eventin, si dekorimet, ushqimet, standat e ekspozitave, logot dhe çdo element tjetër që përbën identitetin e eventit.
 - **Portretet dhe Fotot e Grupit:** Fotografimi i portreteve të organizatorëve, të ftuarve të nderuar, dhe grupeve të rëndësishme për të siguruar një dokumentim të plotë të pjesëmarrësve.
 - **Fotografimi i momenteve të natyrshme rastësore:** Fotografimi i të ftuarve në momente spontane dhe të natyrshme që reflektojnë atmosferën e eventit, si bisedat e çiltra, buzëqeshjet, reagimet emocionuese, etj.
 - **Përdorimi i ndriçimit natyral dhe/ose Artificial:** Menaxhimi i ndriçimit në varësi të hapësirës, duke përdorur ndriçim natyral kur është e mundur dhe ndriçim artificial për të përmirësuar cilësinë e fotografive në rastin kur duhet. Rregullimi i pozicionit të dritave, reflektorëve dhe blicëve për të minimizuar hijet dhe për të krijuar ndriçim të njëtrajshëm dhe të këndshëm në foto.
 - **Komunikimi me AK dhe menaxhimi i kohës:** Vazhdimi i komunikimit gjatë gjithë eventit për të siguruar që të gjitha momentet e planifikuara dhe të papritura të kapen. Rakordimi i programit të eventit dhe koordinimi i punës për të qenë në vendin e duhur në kohën e duhur pa humbur asnjë moment të rëndësishëm.
 - **Siguria e Fotove:** Sigurimi që të gjitha fotot të ruhen në mënyrë të sigurt dhe të mos humben gjatë transferimit dhe përpunimit dhe të dorëzohen të gjitha bruto pranë AK-së në formate digjitale.
 - **Diskrecioni dhe Profesionalizmi:** Qëndrimi diskret dhe profesional gjatë gjithë eventit për të mos ndërprerë rrjedhën e ngjarjeve dhe për të respektuar privatësinë e pjesëmarrësve dhe të ruhet anonimitati i përdorimit të fotove. Këto foto do të konsiderohen pronë e AK-së dhe nuk do të përdoren apo tranferohen drejt palëve të tjera.

2. Shërbim videografimi/filmimi

- **Planifikimi dhe Përgatitja:** Diskutimi me AK për të kuptuar qëllimin e eventit dhe kërkesat specifike për regjistrimin e videove, si momentet kryesore për t'u kapur, stili i dëshiruar (p.sh. dokumentar, artistik, formal) dhe programi i eventit. Kontrollimi dhe përgatitja e pajisjeve si kamerat, mikrofonët, tripodët, stabilizuesit, ndriçimi dhe aksesorët e tjerë. Sigurimi që bateritë dhe kartat e memories janë të plota dhe funksionale. Planifikimi i vizitave në vendin e eventit për të kuptuar vendet më të mira për regjistrim dhe për të planifikuar vendosjen e kamerave dhe ndriçimit.
- **Filmimi i momenteve kryesore:** Regjistrimi i të gjitha momenteve të rëndësishme të eventit, si hyrja e të ftuarve, fjalimet, performancat, ceremonitë dhe momentet e tjera të planifikuara në program.
- **Filmime të detajuara dhe të zakonshme:** Kapja e filmimeve të detajuara (close-ups) për të theksuar detaje të caktuara, si reaksionet e pjesëmarrësve, dekorimet dhe produktet, si dhe filmime më të gjera për të treguar ambientin dhe atmosferën e eventit.
- **Përdorimi i Teknikave të Ndryshme të Xhirimit:** Ndërthurja e filmimeve statike me lëvizjet dinamike për të krijuar një video më tërheqëse dhe të gjallë, duke përdorur tripodë, stabilizues dhe kamera të dorës kur është e nevojshme.
- **Rregullimi i Ndriçimit dhe Zërit të Pastër:** Sigurimi që ndriçimi është i përshtatshëm për filmim, duke përdorur ndriçim natyral ose artificial për të shmangur hijet dhe për të krijuar imazhe të qarta dhe të ndriçuara mirë. Përdorimi i mikrofonëve të jashtëm për të regjistruar zë të pastër dhe të qartë gjatë filmimeve ose intervistave. Monitorimi i vazhdueshëm i cilësisë së zërit gjatë xhirimeve.

- **Koordinimi me Ekipin e Eventit:** Komunikimi me organizatorët dhe pjesëmarrësit për të siguruar që momentet e rëndësishme nuk humben dhe për të koordinuar filmimet pa ndërprerë rrjedhën e eventit.
- **Adaptimi në Situata të Ndryshme:** Fleksibiliteti për të regjistruar momente të papritura dhe për t'u përshtatur me ndryshimet në program, si dhe menaxhimi i kushteve të ndryshme të ndriçimit ose ambientit.
- **Diskrecioni gjatë Xhirimeve:** Të jesh i padukshëm dhe i qetë gjatë eventit për të mos ndërhyrë në atmosferën dhe përvojën e pjesëmarrësve. Këto video do të konsiderohen pronë e AK-së dhe nuk do të përdoren apo tranferohen drejt palëve të tjera.
- **Menaxhimi i Të Dhënave:** Sigurimi që të gjitha materialet e xhiruara të ruhen në mënyrë të sigurt dhe të mos humbasin gjatë transferimit dhe përpunimit dhe të dorëzohen të gjitha bruto pranë AK-së në formate digjitale.

3. Realizim montazh/përpunim video/foto

Zgjedhja e fotografive/videove më të mira që kapin thelbin e eventit dhe që përfaqësojnë më mirë atmosferën dhe emocionet e pjesëmarrësve. Përmirësimi i ngjyrave, ndriçimit, kontrastit dhe mprehtësisë për të siguruar cilësi të lartë të mediave përfundimtare. Realizimi dhe montazhi i fotove/videove për evente të ndryshme në Kopshtin Zoologjik, me fokus në krijimin e materialeve për rrjete sociale dhe promovimin e aktiviteteve.

Kërkesat Teknike:

1. Numri i Videove:

- Shërbimi i videografit do të nevojitet për periudha të ndryshme gjatë vitit, përfshirë Krishtlindjet, Festat e Nëntorit, Dita e Verës, Shën Valentini etj.
- Të realizohen një total prej 25 videosh të shkurtra, për rrjete sociale.

2. Cilësia e Videove:

- Të gjitha videot duhet të realizohen dhe montohen në cilësi 4K (3840 x 2160) ose Full HD.
- Çdo video duhet të ketë një kohëzgjatje maksimale prej 30 sekondash deri në 1 minutë.

3. Formatet e Videove:

- Videot duhet të jenë të montuara në format vertikal (9:16) për t'u përshtatur me formatin e "Reels" në platformat e rrjeteve sociale.

4. Përmbajtja e Videove:

- Videot do të përfshijnë performancat e animatorëve, aktivitete të ndryshme, ambientet kafshët, etj.

5. Elementët e Montazhit:

- Montazhi do të përfshijë:
 - Color correction për përmirësimin e cilësisë së imazhit.
 - Audio postproduction për optimizimin e tingujve dhe përfshirjen e muzikës dhe efekteve akustike.

6. Formatet e Dorëzimit:

-
- Të gjithë materialet e montuara duhet të dorëzohen në formatet e zakonshme për publikim në rrjete sociale (p.sh. MP4, MOV).
 - Të sigurohet një version i redaktuar i videos për publikim dhe ndarje në rrjete sociale.

7. Afatet e Dorëzimit:

- Videot e montuara duhet të dorëzohen brenda një periudhe të arsyeshme pas përfundimit të çdo aktiviteti apo sipas kërkesës, duke u siguruar që ato të jenë gati për publikim në kohë.

8. Kërkesat për Muzikën dhe Efektet:

- Muzika dhe efektet akustike të përdorura në video duhet të jenë pa të drejta autorësie ose të licencuara për përdorim në platforma të ndryshme.

4. Shërbim filmimi me dron

Kapja e pamjeve ajrore për evente të ndryshme në Kopshtin Zoologjik, duke siguruar një perspektivë të gjerë dhe emocionuese të aktiviteteve.

Kërkesat për Dron:

Pamja dhe Kualiteti i Xhirimit: Droni duhet të kapë pamje nga lart të eventeve, duke ofruar një perspektivë të gjerë dhe detaje të qarta. Duhet të jetë i pajisur me kamera ultraportative me cilësi të lartë, të afta për xhirim edhe natën.

Sistemi i Transmetimit: Droni duhet të ketë sistem transmetimi videos O3+ me cilësi të shikimit të drejtpërdrejtë 1080p/60fps.

Automatizimi dhe Kontrolli: Droni duhet të ketë modalitete automatike fluturimi për të lehtësuar kapjen e pamjeve. Të përfshijë një sistem të gjithë-drejtimshëm të shmangies së pengesave me APAS 5.0. aktive 5.0, Hyper Lapse dhe Master Shots për të krijuar pamje kreative dhe dinamike.

Kushtet e Përdorimit: Të sigurohet që fluturimi të jetë i sigurt dhe pa pengesë për pjesëmarrësit dhe vizitorët në event.

5. Shërbim skenë me qira

Për realizimin e eventeve të planifikuara gjatë vitit në Kopshtin Zoologjik

Kërkesat Teknike:

Skenë Platformë (6x4 metra): Një skenë platformë me përmasat 6x4 metra, e përshtatshme për prezantime dhe performanca gjatë eventeve me lartësi sipas kërkesës. Podiumi duhet të jetë i veshur me moket.

Afati i Shërbimit: Shërbimi do të mbulojë një periudhë njëvjeçare, duke përfshirë edhe eventet e mëdha si Krishtlindjet, Vitin e Ri, Ditën e Verës dhe evente të tjera festive, sipas kërkesës së AK-së.

6. Shërbim foni me qira

Për realizimin e eventeve të planifikuara gjatë vitit në Kopshtin Zoologjik

Kërkesat Teknike:

Bokse:

Pajisje audio profesionale (bokse) për të mbuluar evente me audiencë deri në 500 persona. Kërkohet që fonja të jetë e pastër dhe e shpërndarë në mënyrë të barabartë në të gjithë hapësirën.

Teknik Audio:

Një teknik audio përgjegjës për montimin dhe monitorimin e pajisjeve gjatë gjithë kohëzgjatjes së eventit, për të garantuar cilësi të lartë të tingullit dhe funksionim të vazhdueshëm.

Mikrofon Wireless:

Mikrofon wireless për të siguruar prezantime të qarta dhe lëvizje të lirë të folësve ose artistëve pa kufizime teknike.

Ndriçim: Pajisje ndriçimi profesionale për të krijuar atmosferën e duhur, të përshtatshme për ambiente të brendshme dhe të jashtme. Pajisjet duhet të përfshijnë prozhektorë, ndriçim LED dhe sisteme të tjera të përshtatshme për evente festive.

Teknik ndriçimi për të siguruar montimin dhe funksionimin e sistemeve të ndriçimit gjatë gjithë eventit.

Afati i Shërbimit:

Shërbimi do të mbulojë një periudhë njëvjeçare, duke përfshirë edhe eventet e mëdha si Krishtlindjet, Vitin e Ri, Ditën e Verës dhe evente të tjera festive, sipas kërkesës së AK-së.

7. Shërbim LED me qera

Për realizimin e eventeve të planifikuara gjatë vitit në Kopshtin Zoologjik

Kërkesat Teknike:

Led wall 6x4m

Led wall panel 100x50cm

Sistem novastar, 3.91mm

Struktura mbajtëse 4 pllaka hekuri 80x80cm + skeleri vertikale 3m e lart

Procesor novastar vx1000 me 10 dalje ethernet, 2 hyrje HDMI, 1 dvi, 1sdi.

Pedana me përmasa 2x1m

Këmbë teleskopi ke 40-140cm

Shkallë për ngjitje

Copë e zezë për ta mbuluar ballore

2 Elevatore 150kg

Lartësia nga 2-5m

2 amerikan(skeleri) 3m

4 robot beam 280w 12R

4 robot wash 300w led

16 barra led ose par led

2 drita ballore (mediatike për kamerat që filmojnë)

1 splitter ndriçimi 6 kanale

1 hazer (tymuese) opsionale

1 mixer dritash magicQ

4 sub woofer 18" 1800w peak

6 bokse 15" 1200w peak

1 mikser audio 12 kanale

2 mikrofona wireless

2 Sativa mikrofoni

1 laptop me muzikë

8. Shërbim DJ

Për realizimin e eventeve të planifikuara gjatë vitit në Kopshtin Zoologjik

Kërkesat Teknike:

Set DJ + DJ Person:

- Pajisje të plota për DJ, përfshirë konsola, miksera dhe pultet e nevojshme për performanca profesionale.
- Shërbimi i një DJ për të menaxhuar muzikën për minimumi 5 orë, me mundësi përshtatjeje sipas kërkesave të veçanta të eventeve.

9. Shërbim grup me animatore dhe maskota

Ofrimi i shërbimeve të animatorëve në Kopshtin Zoologjik, me qëllim krijimin e një atmosfere argëtuese dhe festive për vizitorët gjatë eventeve të ndryshme. Kontrata do të përfshijë:

Shërbimet e Animatorëve:

Klloun: Aktivitetet argëtuese për fëmijët, duke ofruar humor dhe lojëra që përfshijnë interaktivitet dhe argëtim.

Xhongelier: Performanca me xhonglera për të krijuar një atmosferë festive dhe tërheqëse për të gjitha grupmoshat.

Maskota të Ndryshme: Përfshirja e maskotave sipas rastit, të cilat do të argëtojnë fëmijët dhe vizitorët, duke përmirësuar përvojën e tyre gjatë festave apo ngjarjeve të tjera të rëndësishme.

Face Painting: Shërbimi i pikturimit të fytyrave për fëmijët me motive festive dhe argëtuese, duke i dhënë ngjyrë dhe kreativitet eventit.

Data të Eventeve të Planifikuara:

1. **Festa e Krishtlindjeve:** Animacion i plotë me maskota, kllounë dhe aktivitete festive për të krijuar një përvojë magjike për fëmijët dhe familjet.
2. **Viti i Ri:** Aktivitetet për të festuar ardhjen e Vitit të Ri dhe ndezjen e dritave të pemës së krishtlindjeve, me një atmosferë festive të mbushur me lojëra dhe performanca.
3. **Dita e Verës:** Animatorët do të angazhohen për të sjellë një atmosferë plot gjallëri gjatë Ditës së Verës, duke përfshirë aktivitete jashtë dhe argëtime për të gjitha grupmoshat.

Shtesa: Përfshirja e Babagyshit disa herë gjatë sezonit të Krishtlindjeve për ngjarje të posaçme dhe evente të fundvitit.

10. Fishekzjarre

Fishekzjarrët do të jenë të nivelit të lartë për shfaqje publike, duke përfshirë kombinime të gjalla ngjyrash si e kuqe, e gjelbër, blu, dhe ari.

Lartësia dhe Efektet Vizuale: Shpërthimet do të ndodhin në lartësi mbi 100 metra, duke u përhapur në diametër rreth 50-100 metra.

Kohëzgjatja e Shfaqjes: Shfaqja e fishekzjarrëve do të zgjasë nga 5-10 minuta, me intensifikim gjatë minutave të fundit për të krijuar një finale mbreslënëse dhe të fuqishme.

Siguria dhe Distanca e Lancimit: Fishekzjarrët do të lëshohen nga një distancë sigurie, në një zonë të veçuar pa njerëz dhe objekte të afërta për të garantuar sigurinë e publikut dhe objekteve. Operatori do të ndjekë të gjitha protokollat e sigurisë, duke përdorur pajisje të posaçme dhe mbrojtje personale.

11. Shërbim ndriçimi dhe projektimi

Për realizimin e eventeve të planifikuara gjatë vitit në Kopshtin Zoologjik

Ndriçim: Pajisje ndriçimi profesionale për të krijuar atmosferën e duhur, të përshtatshme për ambiente të brendshme dhe të jashtme. Pajisjet duhet të përfshijnë prozhektorë, ndriçim LED dhe sisteme të tjera të përshtatshme për evente festive. (amerikan (skeleri) 3m, robot beam 280w 12R, robot wash 300w led, barra led ose par led, drita ballore (mediatike për kamerat që filmojnë), splitter ndriçimi 6 kanale, hazer (tymuese) opsionale, mixer dritash magicQ)

Teknik ndriçimi për të siguruar montimin dhe funksionimin e sistemeve të ndriçimit gjatë gjithë eventit.

Afati i Shërbimit: Shërbimi do të mbulojë një periudhë njëvjeçare, duke përfshirë eventet e mëdha si Krishtlindjet, Vitin e Ri, Ditën e Verës dhe evente të tjera festive.

12. Kor fëmijësh

Fëmijët që do të marrin pjesë në këtë event duhet të vijnë me një këngë deri 3 min. Ata do të performojnë për afërsisht 30 minuta sipas programit artistik dirigjuar nga personi përgjegjës.

Afati për realizimin e shërbimeve do të jetë 12 (dymbëdhjetë) muaj për arsye se janë parashikuar evente të cilat janë në muaj të ndryshëm të vitit siç janë Festat e Nëntorit, Festa e Krishtlindjeve dhe Vitit të Ri, Dita e Verës dhe Dita e Fëmijëve, të cilat do të shoqërohen me realizim eventesh të ndryshme.

Vendi i realizimit të shërbimeve: Kopshti Zoologjik i Tiranës, me adresë Rruga “Liqeni i Thatë”, Tiranë, Shqipëri.

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formulari i ofertës ekonomike sipas Shtojcës 1;*

d. *Lista e çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit sipas Shtojcës 2;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për vitet financiare (2021, 2022, 2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më e vogël se 40% të vlerës së parashikuar e kontratës që prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët

ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2. Operatori ekonomik për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave duhet të ketë të punësuar minimalisht 5 (pesë) punonjës, vërtetuar me listëpagesën e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave;

***Shënim:** Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë Autoritetit Kontraktor, përpara publikimit të Njoftimit të Fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar ose me kontratë angazhimi / bashkëpunimi punonjësit e mëposhtëm:

- 1 fotograf, për fotografimin e eventeve me cilësi të lartë;
- 1 videograf/kameraman për filmime profesionale me cilësi të lartë përfshirë dhe filmimin me dron;
- 1 video editor për përpunimin audio dhe video të filmimeve;
- 1 menaxher eventit për implementimin dhe monitorimin e eventit;
- 1 teknik audio për fonin e eventit;
- 1 DJ;
- Grup me 5 animatorë (klloun, xhongelier, këmbëgjatë, maskota të ndryshme dhe persona që realizojnë face painting).

Për punonjësit e mësipërm, ofertuesi duhet të paraqesë:

- CV;
- Kontratë individuale të punës ose shërbimit të vlefshme për të gjithë kohëzgjatjen e kësaj kontrate;

-
- Listëpagesa e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave për punonjësit e siguruar nga operatori ekonomik;

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. ***Të plotësohet formulari përmbledhës i vetëdeklarimit me të dhënat e detajuara për secilin punonjës (emër, mbiemër, detyra që do të realizojë, me kontratë pune apo shërbimi).***

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë Autoritetit Kontraktor, përpara publikimit të Njoftimit të Fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 10.

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

